



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I.Numër:400-01-38597, datë: 04. Maj 2022.

Në bazë të nenit 11, nenit 12. paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës , nenit 2 pika 2.3 të Ligjit Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 30 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 04. Maj 2022, në propozim të Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe kryetarit të Komunës dhe ne rekomandim të KPF-ca, merr :

V E N D I M

Nr.30/2022

Për mbështetje financiare të OJQ “ANIBAR” me seli në Pejë

1. **MIRATOHET** propozimi i DBF-ca dhe kryetarit të Komunës së Pejës, për mbështetje financiare (Subvencionim) të OJQ-së “ANIBAR” me seli në Pejë, në shumë prej: **27,882.26 euro (njëzet e shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy euro e njëzet e gjashtë cent)**, për realizimin e nismës financiare – kofinancim, të mbështetur financiarisht edhe nga Bashkimi Europian për realizimin e projektit Publik Civil për Qeverisjen Inovative të Infrastrukturës Publike në Pejë. Projekt ky trepalësh që financohet nga: OJQ “ANIBAR”, Bashkimi Europian dhe Komuna e Pejës.
2. Mjetet nga pika 1 e këtij konkluzioni do të participohen nga Buxheti Komunal Pejë, Kodi Subvencione.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa të KK. Pejë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përkatëse për qeverisje lokale si dhe 7 (shtat) ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

1x1. MAPL.

1x1. Kryetarit të Komunës

1x1. DBF – ca

1x1. Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
Rexhep Kurtbogaj